



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.249/2022

Datë: 31 maj 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 5 të Rregullores nr. 04/2021 për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, në mbledhjen 288-të, të mbajtur më datë 31 maj 2022, merr këtë:

V E N D I M

- I. Themelohet Komisioni për Rekrutim të bashkëpunëtorëve profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës, në përbërjen si në vijim:
 1. Kadrije Goga – Lubishtani, gjyqtare në Gjykatën Themelore Ferizaj/kryetare e komisionit;
 2. Lirije Maksutaj, gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë/anëtare e komisionit;
 3. Nikola Petronijević, gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë/anëtar i komisionit;
 4. Faton Ademi, gjyqtar në Gjykatën e Apelit/anëtar i komisionit;
 5. Arsim Hamzaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit/anëtar i komisionit;
 6. Liridon Maloku, gjyqtar në Gjykatën e Apelit/anëtar rezervë i komisionit;
 7. Lumnije Krasniqi, gjyqtare në Gjykatën Themelore Prishtinë/anëtare rezervë e komisionit.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 31 maj 2022.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e mbajtur më datë 31 maj 2022, ka shpallur konkurs për bashkëpunëtor profesional në gjykatat e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, në këtë takim ka themeluar Komisionin për Rekrutim i cili është përgjegjës për zhvillimin e procedurave për rekrutimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për bashkëpunëtorë profesional, konform nenit 5 të Rregullores nr. 04/2021 për Procedurën e Rekrutimit dhe Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesional, si në dispozitivë të këtij vendimi.

Gerim ADEMAJ,
Zëvendës Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.